




Emri i Biznesit: Murat V. Musliu B.I.
Emri Tregtar: Radio "Drenica"
NUI: 810620197
Pronari: Murat MUSLIU
OSHMA: Radio DRENICA
Adresa: Sheshi Adem Jashari, Skenderaj

Emri i Biznesit: Hilmi Veliu B.I
Emri Tregtar: Okarina Press
NUI: 811463570
Pronari/Kandidati: Hilmi VELIU
Adresa: Rr/ UCK p.n., Skenderaj



VENDIM

për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Drenica si dhe ndryshimin e emrit në Radio Okarina - me seli në Komunën e Skenderajit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Drenica është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio (Radio), me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetim tokësorë të programeve, në gjuhën shqipe dhe me seli në Komunën e Skenderajit.
3. Me datën 3 dhjetor 2020, Radio Drenica ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë së radio stacionit dhe bartjen e licencës nga biznesi Murat V. Musliu B.I. (emri tregtar Radio "Drenica"), me Numër Unik Identifikues (NUI) 810620197 me pronar z. Murat Musliu, tek, biznesi Hilmi Veliu B.I. (emri tregtar Radio Okarina Press), me Numër Unik Identifikues 811463570 me pronar z. Hilmi Veliu.
4. Më anë të së njëjtës kërkesë, kandidati për pronar të ri ka kërkuar edhe ndryshimin e emrit të Radio Drenica në Radio Okarina.

Arsyetim

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së".
6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termave të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "Për çdo ndryshim në pronësi që kap në shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së"
7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termave të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë."

8. Me anë të kërkesë për ndryshimin e pronësisë së Radio Drenica, pronari aktual ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim janë çështjet personale
9. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio, për publikun, do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
10. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Radio Drenica, përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka paraparë investime në teknologjinë e transmetimit si dhe në angazhimin e stafit profesional dhe me përvojë në fushën e mediave, në mënyrë që transmetimi i programit të jetë më kualitativ, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare kandidati për pronar ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare.
11. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri, për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiar, zotimet për të investuar në teknologjinë e transmetimit si dhe angazhimin e stafit profesional, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Drenica është në interes të publikut.
12. Komisioni konstaton se, ndryshimi i emrit të Radio Drenica në Radio Okarina i pranueshëm ngase nuk ka ndonjë të licencuar tjetër me këtë emër apo emër të ngjajshëm dhe në këtë mënyrë përdorimi i emrit të propozuar për ndryshim, gjatë transmetimit të programeve të radios, nuk do të paraqet pengesa apo konfuzion tek dëgjuesit, prandaj si e tillë kërkesa i plotëson kushtet për miratim.
13. Komisioni konstaton se, sipas kërkesës për ndryshimin e pronësisë, kandidati për pronarë të ri të Radio Drenica është pajtuar që ti marrë përsipër obligimet financiare të Radio Drenica.
14. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.


Vendim

15. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 28 janar 2020, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë së Radio Drenica dhe bartjen e licencës nga biznesi Murat V. Musliu B.I. (emri tregtar Radio "Drenica"), me Numër Unik Identifikues (NUI) 810620197 dhe me pronar z. Murat Musliu, tek biznesi Hilmi Veliu B.I. (emri tregtar Radio Okarina Press), me Numër Unik Identifikues 811463570 dhe me pronar z. Hilmi Veliu
16. Komisioni merr vendim që të miratoj kërkesën për ndryshim të emrit të Radio Drenica në Radio OKARINA.
17. Përveç ndryshimit të pronësisë dhe emrit nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe Pjesës IV – Zonës së Mbulimit.
18. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave




datë